



**LANDWAYS INTERNATIONAL sh.p.k**

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

**Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur**

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 23

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakun e Shoqërisë Landways International sh.p.k

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Landways International sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar në Shqipëri.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencia e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.5.3 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijueshmërisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



30 Korrik 2020

**Irena Hoxha (Pulo)**  
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	29,405,430	71,195,805
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	87,857,231	36,385,509
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	32,579,653	25,116,236
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	683,929	1,817,515
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	6,419,853	9,063,219
Garanci	9	-	934,010
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>156,946,096</b>	<b>144,512,294</b>
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktive afatgjatë materiale	11	18,679,173	23,819,614
Aktive afatgjatë jomateriale	12	630,000	945,000
Investime në pjesmarrje	13	2,913,915	-
Huadhënie afatgjatë	10	727,289,296	535,696,543
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>749,512,384</b>	<b>560,461,157</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>906,458,480</b>	<b>704,973,451</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra	14	75,066,919	63,749,614
Llogari të pagueshme tregtare	15	256,067,320	402,857,677
Llogari të pagueshme tregtare ndaj paleve të lidhura	16	6,107,961	-
Detyrime tatimore	17	4,422,227	6,086,902
Parapagime të marra	18	222,018,481	4,264,083
Të tjera detyrime	19	119,369	1,072,772
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>563,802,277</b>	<b>478,031,048</b>
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Hua afatgjatë	20	147,950,072	53,709,334
<b>Totali i detyrimeve afatgjatë</b>		<b>147,950,072</b>	<b>53,709,334</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>711,752,349</b>	<b>531,740,382</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva të tjera		163,133,069	127,959,001
Fitimi i ushtrimit		31,473,062	45,174,068
<b>Totali i kapitalit</b>	21	<b>194,706,131</b>	<b>173,233,069</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>906,458,480</b>	<b>704,973,451</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	3,469,437,633	3,633,779,322.0
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	23	7,869,456	20,643,126.0
<b>Total të ardhura</b>		<b>3,477,307,089</b>	<b>3,654,422,448</b>
<b>Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime</b>		<b>(3,353,331,195)</b>	<b>(3,551,498,451)</b>
Lënda e parë, materiale të konsumueshme	24	(3,306,323,086)	(3,515,814,445.0)
1) konsumueshme			
2) Të tjera shpenzime	25	(47,008,109)	(35,684,006.0)
<b>Shpenzime të personelit</b>	26	<b>(56,836,109)</b>	<b>(40,080,567)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(48,991,102)	(34,574,815.0)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(7,845,007)	(5,505,752.0)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11	(5,455,441)	(6,430,306.0)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	27	(10,443,157)	(172,588.0)
<b>Shpenzime financiare</b>	28	<b>(12,051,872)</b>	<b>(3,064,117)</b>
Shpenzime interesi dhe			
1) shpenzime të ngjashme		(9,146,057)	(3,064,117.0)
2) Shpenzime të tjera financiare		(2,905,815)	-
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>39,189,315</b>	<b>53,176,419</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>(7,716,253)</b>	<b>(8,002,351.0)</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	29	(7,716,253)	(8,002,351.0)
1) fitimin			
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
2) shtyrë			
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>31,473,062</b>	<b>45,174,068</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>			
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>31,473,062</b>	<b>45,174,068</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Landways International sh.p.k

(Mierat janë në Lekë)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital  
për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Dividendë të paguar	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2018</b>	100,000	92,235,398	-	35,723,603	128,059,001
Fitim/humbja e vitit				45,174,068	45,174,068
Transferim në rezerva të tjera		35,723,603		(35,723,603)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	100,000	127,959,001	-	45,174,068	173,233,069
Fitim/humbja e vitit				31,473,062	31,473,062
Transferim në rezerva të tjera		35,174,068	10,000,000	(45,174,068)	-
Shpërndarje dividendësh			(10,000,000)		(10,000,000)
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	100,000	163,133,069	-	31,473,062	194,706,131

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Landways International sh.p.k. më 31.03.2020 dhe janë firmosur si më poshtë.

  
Eliona Kereci  
Hartues

  
Gazmend Haxhia  
Administrator  
**Landways**  
International  
ESTIMATOR MANAGEMENT COMPANY  
NUJIS: K61422004L



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	31,473,062	45,174,068
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	5,455,441	6,430,306
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(249,394,306)	83,562,193
Rënie/(rritje) në inventarë	-	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(142,303,752)	97,873,472
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	2,643,366	21,824,030
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	216,757,676	5,159,706
Rritje/(rënie) në garanci bankare	934,010	(934,010)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(134,434,503)</b>	<b>259,089,765</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-	(3,603,599)
Arkëtime/ pagesa për investime	(2,913,915)	-
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(2,913,915)</b>	<b>(3,603,599)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Hua të paguara/arkëtuara	105,558,043	(232,097,954)
Dividendë të paguar	(10,000,000)	-
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>95,558,043</b>	<b>(232,097,954)</b>
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(41,790,375)	23,388,212
Mjetet monetare në fillim të periudhës	71,195,805	47,807,593
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>29,405,430</b>	<b>71,195,805</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Landways International" sh.p.k është regjistruar në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 07.11.2005.

Objekti kryesor i Shoqërisë në treg është shitja e biletave të avionit, tragetit dhe trenit në të gjitha destinacionet që menaxhojnë shoqëritë përkatëse, udhëtimet turistike në të gjitha destinacionet turistike në Shqipëri dhe në botë, paketat turistike etj.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 lekë i cili zotërohet nga z. Gazmend Haxhia, ortaku i vetëm i Shoqërisë. Adresa e Shoqërisë është: rruga "Themistokli Gërmenji", pranë zonës së TVSH, Shkalla 1, Kati 1, Tiranë. Administrator i Shoqërisë është z.Gazmend Haxhia. Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT K61422004L.

Shoqëria në fund të periudhës ushtrimore ka 74 punonjës (2018: 75).

Shoqëria ka investime në pjesmarrje në kompaninë Landways d.o.o me seli qendrore në Heinzelova 70 Zagreb, Kroaci. Objekti i vperimtarisë së kompanisë në Kroaci është transporti ndërkombëtar i pasagjerëve. Ortak i kësaj kompanie është edhe Car Rental dhe pjesmarrja është 50% secili nga ortakët.

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

(Vlerat janë në Lekë)

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

#### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarjeje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

#### 2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 i është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

#### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë për llogaritë mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të për llogaritë të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

*(Vlerat janë në Lekë)*

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

*Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

*Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

*Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

##### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje Informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

##### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.5. Aktivet afatgjata jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivit do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

##### Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivitet jo-materiale amortizohen me normën 10% mbi koston historike.



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### 3.7 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### 3.8 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### 3.9 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.11 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### 3.12 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### 3.13 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### 3.14 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## 4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
<b>Mjete monetare në bankë</b>	<b>5,088,825</b>	<b>21,658,111</b>
Në Lekë	4,542,528	7,528,808
Në monedhë	546,297	14,129,303
<b>Mjete monetare në arkë</b>	<b>24,316,605</b>	<b>49,537,694</b>
Në Lekë	23,733,242	40,704,018
Në monedhë	583,363	8,833,676
	<u><b>29,405,430</b></u>	<u><b>71,195,805</b></u>



Landways International sh.p.k  
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019  
 (Vlerat janë në Lekë)

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	98,089,010	36,385,509
Zhvlerësimi	(10,231,779)	-
	<u>87,857,231</u>	<u>36,385,509</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari e arkëtueshme nga palët e lidhura	32,579,653	25,116,236
	<u>32,579,653</u>	<u>25,116,236</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH e arkëtueshme - Leasing	683,929	1,817,515
	<u>683,929</u>	<u>1,817,515</u>

8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzime të shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime	5,045,011	2,029,887
Interesa të përlogaritura	1,374,842	7,033,332
	<u>6,419,853</u>	<u>9,063,219</u>

9. Garanci

Garancitë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Garanci bankare për IATA	-	934,010
	<u>-</u>	<u>934,010</u>

**10. Huadhënie afatgjatë**

Huadhënia afatshkurtër më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Huadhënje afatgjatë	727,289,296	535,696,543
	<u>727,289,296</u>	<u>535,696,543</u>

Landways International sh.p.k  
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019  
(Vlerat janë në Lekë)

11. Aktive afatgjata materiale

Gjendja e aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	Kompjutera	Mobilje e pajisje zyre	Mjete transporti	Të tjera	Totali
<b>Kosto</b>					
Gjendja më 1 janar 2018	12,747,084	2,311,925	25,099,675	1,366,789	41,525,473
Shtesa	2,219,795	1,383,803	-	-	3,603,598
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>14,966,879</b>	<b>3,695,728</b>	<b>25,099,675</b>	<b>1,366,789</b>	<b>45,129,071</b>
Shtesa	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>14,966,879</b>	<b>3,695,728</b>	<b>25,099,675</b>	<b>1,366,789</b>	<b>45,129,071</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>					
Gjendja më 1 janar 2018	6,625,883	1,160,137	7,362,571	45,560	15,194,151
Amortizimi i vitit	1,876,218	434,962	3,804,126	-	6,115,306
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>8,502,101</b>	<b>1,595,099</b>	<b>11,166,697</b>	<b>45,560</b>	<b>21,309,457</b>
Amortizimi i vitit	1,618,348	419,910	2,837,937	264,246	5,140,441
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>10,120,449</b>	<b>2,015,009</b>	<b>14,004,634</b>	<b>309,806</b>	<b>26,449,898</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	6,464,778	2,100,629	13,932,978	1,321,229	23,819,614
Gjendja më 31 dhjetor 2019	4,846,430	1,680,719	11,095,041	1,056,983	18,679,173

## 12. Aktive afatgjata jomateriale

Gjendja e aktiveve afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	AAJM
<b>Me kosto</b>	
Gjendja më 1 janar 2018	3,150,000
Shtesa	-
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>3,150,000</b>
Shtesa	-
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>3,150,000</b>
<b>Zhvlërësimi akumuluar</b>	
Gjendja më 1 janar 2018	1,890,000
Zhvlërësimi i vitit	315,000
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>2,205,000</b>
Zhvlërësimi i vitit	315,000
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>2,520,000</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2018</b>	<b>945,000</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2019</b>	<b>630,000</b>

## 13. Investim në pjesëmarrje

Investim në pjesëmarrje për vitin 2019 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Investim në pjesmarrje	2,913,915	-
	<b>2,913,915</b>	<b>-</b>

Shoqëria ka investime në pjesëmarrje në kompaninë Landways d.o.o me seli qendrore në Heinzelova 70 Zagreb, Kroaci. Objekti i vperimtarisë së kompanisë në Kroaci është transporti ndërkombëtar i pasagjerëve. Ortak i kësaj kompanie është edhe Car Rental dhe pjesëmarrja është 50% secili nga ortakët.

## 14. Hua afatshkurtër

Llogaria e huasë aftashkurtër më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Karte krediti	9,294,322	5,593,611
Overdraft	31,658,327	30,849,329
Huamarrje afatshkurtër	33,237,694	27,306,674
Interesa te perllogaritura	876,576	-
	<b>75,066,919</b>	<b>63,749,614</b>

**15. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të pagueshme tregtare	245,405,663	397,823,047
Furnitorë për fatura të pambërritura	10,661,657	5,034,630
	<u>256,067,320</u>	<u>402,857,677</u>

**16. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura gjatë vitit 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të pagueshme tregtare ndaj palëve të lidhura	6,107,961	-
	<u>6,107,961</u>	<u>-</u>

**17. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,200,299	854,528
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	296,923	123,162
Tatim fitimi	135,495	2,062,267
TVSH për tu paguar	2,738,013	2,994,928
Tatim në burim	51,497	52,017
	<u>4,422,227</u>	<u>6,086,902</u>

**18. Parapagimet dhe të ardhura të shtyra**

Parapagimet dhe të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime të vitit	222,018,481	4,264,083
	<u>222,018,481</u>	<u>4,264,083</u>

**19. Të tjera detyrime**

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga të pagueshme	119,369	-
Të tjera detyrime		1,072,772
	<u>119,369</u>	<u>1,072,772</u>

## 20. Hua afatgjatë

Llogaria hua aftagjatë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua afatgjatë	147,950,072	53,709,334
	<u>147,950,072</u>	<u>53,709,334</u>

## 21. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 LEK i zotëruar 100% nga ortaku i Landways International sh.p.k, Z. Gazmend Haxhia.

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale	1,000	1,000
Kapitali themeltar	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

Shuma prej 163,133,069 Lekë përfaqëson rezerva të tjera (2018: 127,959,001 Lekë).  
 Shuma prej 31,473,062 Lekë përfaqëson fitimin e ushtrimit (2018: 45,174,068 Lekë).

## 22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga organizim për ture për grupe	3,074,638,966	3,259,960,945
Të ardhura nga konferenca për evente	171,543,809	164,656,705
Të ardhura nga shitje bileta udhëtimi	137,529,170	125,756,472
Të ardhura nga transporti	1,646,436	787,288
Të ardhura nga shërbime akomodimi	1,361,367	8,293,480
Të ardhura nga qiraja	3,244,431	15,183,527
Të ardhura nga Crociere	78,157,056	56,515,180
Të ardhura të tjera	1,316,398	2,625,725
	<u>3,469,437,633</u>	<u>3,633,779,322</u>

23. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së

	<u>31 dhjetor 2019</u>
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Qarkullim i tatueshëm	3,706,615,474
Shtohen parapagimet në çelje	4,264,083
Shtohen te ardhurat e viteve te shkuara	1,074,325
Zbriten parapagimet e vitit	(222,018,481)
Zbriten të ardhura të periudhave të ardhme	(20,497,768)
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<u>3,469,437,633</u>
Sipas Kontabilitetit	3,469,437,633
<b>Diferenca</b>	<u>-</u>

24. Të ardhurat të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	(10,542,738)	(19,739,762)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	18,412,194	40,382,888
	<u>7,869,456</u>	<u>20,643,126</u>

25. Lëndë e parë, materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e shërbimeve të ofruara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Akomodime	26,053,824	17,230,590
Shpenzime për grupe	2,966,370,824	3,141,543,450
Shpenzime transporti	470,014	3,712,639
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	24,482,404	81,999,189
Shpenzime për bileta	141,554,875	147,158,907
Shpenzime qeraje	349,097	2,500,000
Shpenzime eventesh	99,401,243	87,636,591
Shpenzime crociere	47,640,805	34,033,079
	<u>3,306,323,086</u>	<u>3,515,814,445</u>



## 26. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzim energjie	330,562	233,833
Shpenzime qiraje pajisje	4,194,309	5,567,609
Kancelari	1,945,273	1,180,485
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	2,189,910	2,408,921
Shpenzime për kreditë	-	45,444
Komisione bankare	11,136,483	11,296,638
Taksa doganore dhe bashkiake	401,279	279,575
Shpenzime të tjera	3,675,178	2,174,889
Mirëmbajtje	272,004	1,405,021
Shpenzime doganore	11,352	16,975
Shpenzime trajnimi	1,195,527	10,653
Shpenzime konsulence dhe auditimi	10,014,783	9,893,976
Shpenzime pritje dhe perfaqësimi	10,481,339	902,901
Shpenzime noteriale	-	93,833
Sigurime	1,160,110	173,253
	<b><u>47,008,109</u></b>	<b><u>35,684,006</u></b>

## 27. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për paga	48,991,102	34,574,815
Shpenzime për sigurime shoqërore	7,845,007	5,505,752
	<b><u>56,836,109</u></b>	<b><u>40,080,567</u></b>

Shoqëria në fund të periudhës ushtrimore ka 74 punonjës (2018: 75).

## 28. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penaltetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Gjoha	211,378	129,893
Shpenzime zhvlerësimi	10,231,779	42,695
	<b><u>10,443,157</u></b>	<b><u>172,588</u></b>

## 29. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, të ardhurat nga këmbimet valutore dhe shpenzime të tjera financiare që lidhen me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime financiare	9,146,057	3,064,117
Shpenzime të tjera financiare	2,905,815	-
	<u>12,051,872</u>	<u>3,064,117</u>

## 30. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	39,189,315	53,176,419
<b>Total shpenzime të panjohura</b>	<b>12,252,370</b>	<b>172,588</b>
Shpenzime interesi	1,809,213	
Penalitete, gjopa e dëmshpërblime	211,378	172,588
Shpenzime zhvlerësimi	10,231,779	
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>51,441,685</b>	<b>53,349,007</b>
Humbje fiskale e mbartur	-	-
<i>Tatim fitimi @15%</i>	7,716,253	8,002,351
	<u>31,473,062</u>	<u>45,174,068</u>

## 31. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>		<u>31 dhjetor 2018</u>	
	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>
A.S.G	440,836,473	-	365,203,933	-
Ortaku	32,579,653	-	25,116,236	-
Noshi	196,775,478	-	166,312,474	-
Landways D.O.O	89,677,345	6,107,961	4,180,136	-
	<u>759,868,949</u>	<u>6,107,961</u>	<u>560,812,779</u>	<u>-</u>

32. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
A.S.G	-	99,986,836	-	121,541,650
Noshi	-	-	-	-
Landëays D.O.O	-	54,900,974	-	-
	-	<b>154,887,810</b>	-	<b>121,541,650</b>

33. Angazhime dhe pasiguri

*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

34. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i llogarive te arketueshme dhe inventarit mund të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.